

LE POESIE DA VILHELME VRANARI (HAXHIRAJ)

Traduzione in italiano di Prof. PETRAQ TRUJA

-1-

\*RRËNJËT

Rrënjët...  
këtu i mbollën,  
në këtë tokë të larë  
në gjak.  
Degët...  
nëpër botë janë shpërndanë  
Syri...  
lot pikoi,  
kur dritën e së vërtetës ai pa...  
Gjuhën e mëmës...  
ëmbël shqiptuan,  
atje, ku rrënjët hodhën shtat.  
Horizontet e përflakura  
shijuan...  
aty,  
ku blegërin qengji manar  
Nëpër botë kërkuan,  
askund nuk i panë,  
u kthyen e i gjetën  
rrënjët...  
aty, ku i lan

\* LE RADICI

Qui,  
piantammo le radici,  
in questa terra  
lavata di sangue...  
I ramoscelli...  
si sono sparpagliati nel mondo.  
Nell'occhio...  
una lacrima spunto',  
quando la luce della verità l'avisto'.  
la lingua materna...  
si pronunciava dolcemente,  
lì... dove le radici si sono messe.  
Gustarono gli orizzonti fiammeggianti  
lì, dove l'agnellino correndo il segue  
balenando...  
Cercando per il mondo,  
non hanno visto niente di loro radici.  
Ma ritornando, le hanno trovato,  
le radici...  
lì', dove aveviano laschiate...!

-2-

\*SIKUR...

Sikur jeta  
të ishte si një këngë  
do të njihje  
vetëm dashurinë.  
  
Sikur pranvera  
të ishte e vetmja stinë  
do dhuronte  
parfumin e paqes dhe të mirësisë.  
  
Sikur dielli  
të ngrohte nëlloj çdo ditë  
do ta largonte dimrin e zyrtë  
me acar dhe cingërimë.  
  
Sikur njerëzit.  
të kishin tolerancë e mirëkuptim,  
atëherë të shikonit...  
se si do të ishte vendi im!

\* SE...

Se la vita  
fosse un canto,  
conoscerebbe  
solo l'amore.  
  
Se la primavera  
fosse l'unica stagione,  
regalerebbe  
il profumo della pace e della bontà  
  
Se il sole  
ricaldasse ugualmente tutti i giorni,  
allontanerebbe il cupo inverno  
pieno di freddo e gelido vento.  
  
Se la gente  
fosse tollerante e di buon senso,  
allora vedreste  
Come sarebbe il mio paese!